

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

PËR

“PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË SIGURISË NË KOMUNITET 2021-2026”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave synon miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026, pas përfundimit të zbatimit të Strategjisë së Rendit Publik dhe Planit të Veprimit 2015-2020, si dhe dokumentit të Policimit në Komunitet, i miratuar me urdhër të Ministrit të Brendshëm nr. 645, datë 10.12.2018.

Ministria e Brendshme në bashkëpunim me institucionet e tjera, në rolin e institucionit lider, ka hartuar Strategjinë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet, dhe ka planifikuar objektiva strategjike dhe specifike konkret për çështjet e sigurisë.

II. VLERËSIMI I PROJEKT-AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektakti është diktuar nga nevoja për rinovimin e Strategjisë së Rendit dhe Sigurisë Publike 2015-2020, dokumentit të Policimit në Komunitet 2018-2020, si dhe një sërë strategjish dhe plan veprimesh të ndryshme të lidhura me çështje të sigurisë në komunitet, të cilat kanë përfunduar ose përfundojnë në vitin 2020. Gjithashtu, ky projektakt është parashikuar në katërmujorin e tretë të programit analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2020, “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020”, të ndryshuar.

Projektvendimi është në përputhje me nenin 100, pika 1 e Kushtetutës, ku përcaktohet se Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”, ku përcaktohet se Ministria e Brendshme”, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi është institucioni përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2026 parashikon objektiva strategjike, objektiva specifike, si dhe dhe masat përkatëse që duhet të realizohen për përmbushjen e këtyre objektivave sipas afateve të përcaktuara.

Ky dokument ka si qëllim jetësimin dhe realizimin në kohë dhe më cilësi të 3 objektivave strategjike, duke synuar rritjen e parametrave të sigurisë në komunitet, angazhimin dhe ndërveprimin me komunitetin, si dhe reformimin e shërbimit policor dhe rritjen e kapaciteteve për policimin në komunitet, të cilat arrihen duke zbatuar masat nga institucionet përgjegjëse brenda afateve kohore. Strategjia synon arritjen e rezultateve nëpërmjet përpjekjeve në fushën e sigurisë në komunitet, duke marrë parasysh mësimet e nxjerra nga dokumentet e mëparshme strategjike në këtë fushë, si dhe rekomandimeve në procesin e integritimit evropian.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi i paraqitur është në harmoni me rendin juridik të brendshëm. Ai është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe veçanërisht nenin 100 të saj, sipas të cilit “Këshilli i Ministrave merr vendime për përcaktimin e drejtimeve kryesore të politikës shtetërore”, vendimin nr. 502, datë 13.09.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk përafrohet në vetvete një akt të legjislativitetit të Bashkimit Evropian, por do të shërbejë si instrument për adresimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian për përafrimin me *acquis communautaire* të BE, për fushën e rendit dhe sigurisë publike.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-AKTIT

Projekti përmban kontekstin strategjik i cili përshkruan qëllimin e hartimit të këtij dokumenti, 3 politikat (drejtime kryesore strategjike), kuadrin ligjor, arritjet dhe mësimet, qëllimin e politikave dhe objektiva specifike të strategjisë, institucionet përgjegjëse që ngarkohen me zbatimin e saj, mënyrën e raportimit dhe monitorimit të strategjisë.

Ky dokument mbështetet në 3 objektiva strategjike si më poshtë:

1. Rritja e parametrevave të sigurisë në komunitet;
2. Angazhimi dhe ndërveprimi me komunitetin;
3. Reformimi i shërbimit policor dhe rritja e kapaciteteve për sigurinë në komunitet.

Qëllimet kryesore të këtij dokumenti janë evidentimi, parandalimi i krimit, ndëshkimi, ndërgjegjësimi/edukimi rreth çështjeve të sigurisë, si dhe ndërveprimi me komunitetin në interes të drejtëpërdrejtë të sigurisë dhe cilësisë së jetës së qytetarëve.

Strategjia orientohet në 3 drejtime kryesore, të cilat ndahen në disa objektiva specifike, si dhe masa të përcaktuara në përmbushje të tyre. Hartimi i këtyre objektivave, masave dhe aktiviteteve që duhet të kryhen është bërë në bashkëpunim të ngushtë dhe gjithëpërfshirës me institucionet që kanë kontribuar në hartimin e këtij dokumenti.

Politika 1 konsiston në 3 objektiva specifike si:

- **Objektivi specifik 1.1** Rritja e sigurisë në komunitet bazuar në vlerësimin e risqeve dhe proaktivitetin;
- **Objektivi specifik 1.2** Evidentimi, parandalimi dhe trajtimi në kohë të problematikave të komunitetit dhe çështjeve të rëndësishme që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet;
- **Objektivi specifik 1.3** Rritja e efikasitetit të kontrollit të territorit.

Politika 2 konsiston në 3 objektiva specifike si:

- **Objektivi specifik 2.1** Përmirësimi i komunikimit me publikun;
- **Objektivi specifik 2.2** Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin;

- **Objektivi specifik 2.3** Mbështetja e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe mirëfunksionimi i Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP).

Politika 3 konsiston në 2 objektiva specifike si:

Objektivi specifik 3.1 Përmirësimi i strukturave në shërbim të komunitetit dhe krijimi i një strukture të posaçme të dedikuar për policimin në komunitet;

Objektivi specifik 3.2 Përmirësimi i kushteve të punës, performancës, kapaciteteve profesionale dhe motivimit të punonjësve të policisë.

Objektivi specifik 1.1 Rritja e sigurisë në komunitet bazuar në vlerësimin e risqeve dhe proaktivitetin synohet të arrihet nëpërmjet masave si:

Masa 1. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional për vlerësimin e riskut dhe dëmit dhe masat parandaluese;

Masa 2. Realizimi i vlerësimeve të riskut mbi baza lokale nga Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike;

Masa 3. Proaktiviteti i shërbimit policor në lidhje me përmirësimin e sistemit të menaxhimit të rasteve.

Objektivi specifik 1.2 Evidentimi, parandalimi dhe trajtimi në kohë i problematikave të komunitetit dhe çështjeve të rëndësishme që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet synohet të arrihet nëpërmjet masave si:

Masa 4. Parandalimi nëpërmjet evidentimit dhe ndërgjegjësimit, i orientuar nga Inteligjenca dhe Informacioni;

Masa 5. Parandalimi nëpërmjet edukimit.

Objektivi specifik 1.3 Rritja e efikasitetit të kontrollit të territorit synohet të arrihet nëpërmjet masave si:

Masa 6. Zbatimi i përgjegjësisë në nivel qendror dhe vendor për kontrollin e territorit;

Masa 7. Përdorimi i teknologjive të reja për kontrollin e territorit.

Objektivi specifik 2.1 Përmirësimi i komunikimit me publikun synohet të arrihet nëpërmjet masave si:

Masa 8. Hartimi dhe zbatimi i masave të reja për të përmirësuar kontaktet e drejtëpërdrejta me publikun dhe komunitetet;

Masa 9. Përmirësimi i komunikimit dhe angazhimit efektiv me partnerët dhe komunitetet në nivel lokal dhe kombëtar;

Masa 10. Hartimi dhe zbatimi i masave për të përmirësuar komunikimin me mediet;

Masa 11. Zbatimi i masave të komunikimit në kuadër të programit të transparencës për të përmirësuar sistemin e raportimit dhe informimit të publikut.

Objektivi specifik 2.2. Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin nëpërmjet funksionimit të KVSP-ve synohet të arrihet nëpërmjet masave si:

Masa 12. Funksionimi i plotë i Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP);

Masa 13. Fuqizimi i roleve të aktorëve të tjerë që kontribuojnë në sigurinë në komunitet.

Objektivi specifik 2.3. Rritja e mbështetjes së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për sigurinë në komunitet synohet të arrihet nëpërmjet masave si:

Masa 14. Krijimi i një fondi të vecantë për sigurinë në komunitet;

Masa 15. Rishikimi i rolit dhe përgjegjësisë të policisë bashkiake;

Masa 16. Konsolidimi i strukturave të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike;

Masa 17. Rishikim i akteve ligjore për përmirësimin e detyrave të administratorëve të njësive administrative, hapjen e zyrave dhe shërbim të përhershëm të policisë në çdo bashki dhe njësi administrative.

Objektivi specifik 3.1. Përmirësimi i strukturave në shërbim të komunitetit dhe krijimi i një strukture të posaçme të dedikuar për policimin në komunitet synohet të arrihet nëpërmjet masave si:

Masa 18. Fuqizimi i burimeve njerëzore;

Masa 19. Rritja e kapaciteteve.

Objektivi specifik 3.2. Përmirësimi i kushteve të punës, performancës dhe motivimit të punonjësve të policisë synohet të arrihet nëpërmjet masave si:

Masa 20. Krijimi i zyrave të reja në zonat policore urbane dhe rurale;

Masa 21. Rikonstrukcioni i zyrave ekzistuese në zonat policore urbane dhe rurale;

Masa 22. Kompletimi me infrastrukturë për punë i zyrave në zonat policore urbane dhe rurale, me uniformë dinjitoze dhe mjete e pajisje policie;

Masa 23. Motivimi i punonjësve të policisë të zonës policore.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI

Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2026 do të zbatohet nga ministritë e linjës, institucionet e tjera, të cilat kanë një rol të veçantë në

çështjen e sigurisë në komunitet, si dhe institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Brendshme/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Qendra Kombëtare për Ekstremizmin e Dhunshëm, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Nisma për hartimin e këtij projektakti është ndërmarrë nga Ministria e Brendshme si institucion përgjegjës për fushën e rendit dhe sigurisë publike bazuar kjo dhe në fushën e saj të përgjegjësisë të rregulluar me vendimin nr. 502, datë 13.09.2017, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”.

Ministritë e linjës, institucione të tjera si Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Qendra Kombëtare për Ekstremizmin e Dhunshëm etj kanë dhënë kontributin e gjatë fazës së hartimit të kësaj strategjie.

Projektvendimi dhe relacioni shoqërues do të përcillen me shkresë zyrtare për mendim pranë:

Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;

Prokurorisë së Përgjithshme;

Qendrës Kombëtare për Ekstremizmin e Dhunshëm;

Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;

Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Mjedisit;

Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Ndërsa nëpërmjet sistemit e-aktet pranë:

Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

Ministrisë së Drejtësisë;

Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;

Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare përlogariten nga çdo institucion bazuar në implementimin e aktiviteteve të masave përkatëse që janë të parashikuara në Planin e Veprimit të kësaj Strategjie. Efektet financiare përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara me zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, në mënyrë të detajuar.

MINISTRI

SANDËR LLESHAJ